



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.11, datë 31.03.2026

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE (AKEP)”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 31.03.2026, të zhvilluar në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”

BAZA LIGJORE:

Në mbështetje të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike, marrëdhëniet e punës, rregullat e etikës, të drejtën e informimit, administrimin e dokumentacionit dhe parandalimin e konfliktit të interesave, në përputhje me parimet e mirëadministrimit dhe funksionimit efikas të institucioneve të pavarura.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Projektvendimi i arsyetuar;
- Relacioni shpjegues i projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54, datë 30.05.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP ka detyrimin të përditësojë dhe miratojë aktet e tij të brendshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucionit, në përputhje me dispozitat e reja ligjore dhe zhvillimet institucionale.
2. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e AKEP dhe rekomandimet për vitin 2025 ngarkojnë institucionin të vijojë procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 54/2024.
3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka analizuar rregulloret ekzistuese të brendshme të AKEP dhe në funksion të harmonizimit me legjislacionin në fuqi dhe strukturën organizative, ka hartuar draftin e rregullores së re.
4. Rregullorja e re synon harmonizimin e plotë të rregullave të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e Këshillit Drejtues si organ kolegjal dhe administratës së AKEP në nivel ekzekutiv me ndryshimet e ndodhura në legjislacionin në fuqi, duke siguruar ndarjen e qartë të kompetencave dhe përgjegjësisë të çdo strukture.
5. Në përputhje me parimin e autonomisë institucionale të përcaktuar në ligj, AKEP ushtron të drejtën për të miratuar aktet e brendshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 7, datë 16.02.2017 rregullore e brendshme “Për funksionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, e ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 6, datë 16.02.2017 rregullore e brendshme “Për funksionimin e administratës AKEP”, e ndryshuar shfuqizohen.
3. Ngarkohet e gjithë struktura organizative e AKEP për zbatimin e detyrimeve të këtij vendimi, sipas fushës së përgjegjësisë së secilës njësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Armer Juka	Bleron Dokle	Edlira Dvorani	Lorenc Bako